



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|----------------------------|------------|-------------------|-------------------|
| Pranuar - Primjeto Me/Dana | | 28.07.2017 | |
| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| | 01-016/775 | | |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.07.2017, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të klubeve futbolistike që garojnë në superligë dhe ligën e parë

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndajë të mjeteve financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve të Klubeve futbolistike që garojnë në superligë dhe ligën e parë.

Neni 2

Me këtë vendim ndahen mjete financiare për superligë në shumën prej 30.000 euro (tridhjet mijë euro) dhe për ligën e parë 20.000 (njetzet mijë euro) për subvencionimin e aktiviteteve të klubeve futbolistike.

Neni 3

Klubet futbolistike janë të obliguar të paraqesin projekt propozimet, në të cilën duhet të paraqiteten aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare.

Neni 4

Klubet futbolistike janë të obliguar de jure të ofroj dëshmi në mënyrë që të përfitojn nga ky subvencionim.

Neni 5

Mjetet financiare ndahen nga buxheti, fondi burimor 21, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, programi buxhetor, Zyra e Kryetarit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 7

Ky vendim është i aplikueshëm deri sa të qfuqizohet me ndonjë vendim tjetër.

Neni 8

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorezohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
3. Klubeve Futbollistike;
4. Shërbimit të Kuvendit;
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Najm Pira

